L I G J
Nr.9115, datë 24.7.2003

PËR TRAJTIMIN MJEDISOR TË UJËRAVE TË NDOTURA

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011; nr. 34/2013, datë 14.2.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Neni 2
Objekti

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:
a) ujërat e ndotura urbane;
b) ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë;
c) ujërat nga kullimi i tokave bujqësore;
ç) ujërat e ndotura të çdo lloji.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Ujërat e ndotura urbane" janë ujërat e përdorura që shkarkohen nga banesat dhe veprimtaritë e caktuara industriale, të cilat përmbajnë lëndë të tretura dhe lëndë në pezulli.

2. "Ujërat e ndotura shtëpiake" janë ujërat e përdorura të çdo lloji, me përbërje organike, të degradueshme, lëndë minerare në formë të tretur ose në pezulli, të shkarkuara nga instalimet hidraulike të çdo lloji.

3. "Ujërat e ndotura industriale" janë ujërat e përdorura nga veprimtaritë tregtare dhe industriale.

4. "Mjedis pritës" përfaqëson zonat e shkarkimit të ujërave të përdorura.

5. "Aglomerat-zonë urbane intensive" është një zonë ku popullsia dhe veprimtaria ekonomike ka një përqendrim të tillë, i cili bën të nevojshëm që shkarkimet e lëngëta urbane të grumbullohen dhe të sistemohen në një pikë të vetme shkarkimi ose të futen në një impiant

trajtimi.

6. "Sistemi kolektor" është sistem kanalizimesh, unik ose i ndarë, që grumbullon dhe sistemon shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe industriale.

7. "Njëvlerës për popullsinë" është ndotja mesatare e derdhjes për banorë në ditë, që ka 90 gr/ditë lëndë në pezulli, 60 gr/ditë lëndë organike, 15 gr/ditë azot amoniakal dhe 4 gr/ditë fosfor.

8. "Trajtim parësor" është trajtimi i ujërave të përdorura, nëpërmjet procesit fizik me anë të dekantimit parësor, që mënjanon 60 për qind të lëndës në pezulli dhe 20 për qind të NBO5.

9. "Trajtim dytësor" është trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet procesit biologjik, me shtrat bakterial, basen ajrimi, llum aktiv, duke u shoqëruar, në raste të veçanta, me trajtim tretës (dekantim/filtrim), për realizimin e denitrifikimit dhe defosfatimit.

10. "Trajtim i përshtatshëm" është trajtimi i ujërave të ndotura urbane, nëpërmjet një procesi të dhënë, nga i cili rezulton që shkarkimet e lëngëta në ujërat pritëse nuk dëmtojnë cilësitë e këtyre ujërave, në përputhje me ligjin.

11. "Llum" është mbetja e ngurtë dhe gjysmë e ngurtë, që përftohet gjatë proceseve të trajtimit të ujërave të ndotura.

12. "Eutrofikim" është pasurimi i një ekosistemi ujor me lëndë ushqyese, veçanërisht, me përbërës azoti dhe fosfori dhe me prodhimtari të lartë biologjike, duke shkaktuar një rritje të vrullshme të algave dhe formave të larta të jetës bimore, të shoqëruara me ndryshime të cilësisë së ujit.

13. "Estuar" është zona kalimtare e ujërave sipërfaqësore në grykëderdhjen e lumit në det.

14. "Ujëra bregdetare" janë ujërat jashtë vijës së ujërave të ulëta ose ujërat jashtë kufijve të estuarit.

15. "Nevoja biologjike për oksigjen NBO5" është sasia e oksigjenit të konsumuar gjatë 5 ditëve nga bakteret aerobe në prani të ajrit. Ajo përfaqëson ndotjen organike të biodegradueshme.

16. "Zona të ndjeshme" janë zonat që përfshihen në liqenet natyrore me ujë të ëmbël; ujërat e ëmbla sipërfaqësore, të destinuara për nxjerrjen e ujit të pijshëm; grykëderdhjet, estuaret dhe ujërat bregdetare, të cilat janë përcaktuar si eutrofike, ose vlerësohen të mundshme për t'u bërë të tilla.

17. "Zonat më pak të ndjeshme" janë zonat që përfshihen: në gjiret e hapura, grykat dhe ujërat e tjera bregdetare me një shkëmbim të kënaqshëm të ujërave dhe që nuk janë subjekt ndaj eutrofikimit ose shterimit të oksigjenit, ose vlerësohen të vështira për t'u bërë eutrofike, si pasojë e shkarkimeve të ujërave të ndotura.

18. "Monitorimi" është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i të dhënave mjedisore me anë të vëzhgimit të vazhdueshëm ose periodik të një grupi treguesish mjedisorë, cilësorë dhe sasiorë, që karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrorë ose njerëzorë.

Neni 4
Detyrat e organeve shtetërore

1. Ministria e Mjedisit, agjencitë rajonale dhe Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, krahas organeve të ngarkuara me ligj për administrimin e rezervave ujore, ndihmojnë funksionimin e procesit të trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura dhe kontrollojnë zbatimin e tij në të gjitha nivelet.

2. Organet shtetërore, qendrore e vendore, secili në linjën e vet, bashkëpunojnë me

Ministrinë e Mjedisit për:

a) përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura, në përputhje me llojin e natyrën e tyre;

b) hartimin e planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në mënyrë të integruar, si pjesë e planeve të menaxhimit të baseneve ujëmbledhëse përkatëse;

c) krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura;

ç) përsosjen e rrjetit institucional përgjegjës;

d) sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;

dh) kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive, që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre.

KREU II
PARANDALIMI I NDOTJES SË UJIT DHE PAKËSIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

Neni 5
Synimet e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura

Procesi i trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura synon:

a) u1jen e prodhimit të ujërave të ndotura nga veprimtaritë prodhuese dhe të ngarkesës ndotëse në to;

b) përdorimin e teknikave dhe metodave më të mira të mundshme, të bazuara në kritere mjedisore, të miratuara me një akt normativ;

c) masat mbrojtëse, teknike e teknologjike, domosdoshmërisht të zbatueshme, që prej përdoruesit të tij;

ç) shkurtimin e kohës së ekspozimit të tyre në mjedis;

d) trajtimin e ujërave të ndotura në një fazë të mëparshme, që të mos pengojë përpunimin dhe përdorimin e mëtejshëm të ujërave të ndotura;

dh) pakësimin sa më shumë të lëvizjes së lirë të ujërave të ndotura dhe trajtimin sa më pranë burimit dhe në impiantin më të afërt;

e) parandalimin e ndotjes së mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh;

ë) dëmshpërblimin për ndotjen dhe rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar që kanë shkaktuar personat fizikë ose juridikë, me shkarkimin e ndotësve në ujëra tej normave të lejuara.

Neni 6
Detyrime të personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura

1. Personat fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve shkarkon ujëra të ndotura, detyrohen të marrin masat që:

a) të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës;

b) të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme;

c) të administrojnë dhe të trajtojnë ujërat e ndotura nëpërmjet:

i) ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të kanalizimeve të brendshme;

ii) ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të trajtimit, në përputhje me kërkesat e veçanta, sipas degës së industrisë, së cilës i përket veprimtaria;

iii) ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit të kanalizimeve, për largimin e ujërave të

ndotura urbane dhe të shkarkimeve industriale deri në kolektor;

iv) nxitjes së ripërdorimit të dobishëm të ujërave të trajtuara;

v) trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, sipas kërkesave dhe kushteve të vendosura në lejen mjedisore;

vi) zbatimit të normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe të metodave e teknologjive bashkëkohore të trajtimit të ujërave të ndotura.

2. Për plotësimin e këtyre detyrimeve, personi fizik ose juridik, veprimtaria e të cilit shkarkon ujëra të ndotura, harton programin e masave teknike, teknologjike e organizative të trajtimit të tyre, i cili kontrollohet nga Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, organi që e ka licencuar veprimtarinë dhe nga organet e qeverisjes vendore të zonës.

Neni 7

Detyrimet e trajtuesve të ujërave të ndotura

1. Personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që marrin përsipër trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura, sigurojnë:

a) zbatimin e kërkesave teknike, metodike dhe organizative për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;

b) zbatimin e kushteve dhe të kërkesave, të përcaktuara në lejen mjedisore;

c) shkarkimin e ujërave të trajtuara në mjedisin pritës vetëm kur ato janë brenda normave të lejuara;

ç) trajnimin e stafit që merret me impiantet dhe instalimet e trajtimit e të pastrimit të ujërave të ndotura;

d) hartimin dhe administrimin e dokumentacionit, ku pasqyrohen të gjitha veprimet e proceset që kryhen për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;

dh) mbajtjen e regjistrave të veçantë, sipas ndarjes dhe klasifikimit të ujërave të ndotura, për sasinë, përmbajtjen dhe pastrimin e këtyre ujërave;

e) trajtimin e llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga pastrimi i ujërave, sipas kërkesave të administrimit të mbetjeve të ngurta;

ë) lehtësimin e kontrollit të inspektorëve;

f) kontratat me personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, veprimtaritë e të cilëve krijojnë ujëra të ndotura, duke përcaktuar me hollësi detyrimet përkatëse.

2. Trajtuesit e ujërave të ndotura janë përgjegjës për dëmet që shkaktojnë në shëndet dhe në mjedis. Ata janë të detyruar të dëmshpërblejnë për ndotjen dhe të rehabilitojnë mjedisin me shpenzimet e veta. Rregullat dhe procedurat për vlerësimin e dëmit dhe rehabilitimin e mjedisit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mjedisit.

KREU III
TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA SIPAS LLOJIT

Neni 8

Trajtimi i ujërave të ndotura industriale

1.Çdo subjekt, veprimtaria e të cilit krijon ujëra të ndotura industriale, i trajton ato në përputhje me veçoritë e degëve të industrisë.

2. Trajtimi i ujërave të ndotura industriale është një proces ku përfshihen:

a) trajtimi paraprak nga veprimtaria që i krijon;

b) trajtimi nga personat fizikë dhe juridikë, që marrin përsipër pastrimin e tyre, nëpërmjet vendosjes dhe vënies në funksionim të impianteve të trajtimit;

c) ndalimi i ripërdorimit të ujërave industriale të trajtuara;

ç) ndalimi i përdorimit të llumrave të mbetura pas procesit të pastrimit të tyre;

d) depozitimi përfundimtar i mbetjeve të ngurta në vende të caktuara.

3. Në përfundim të trajtimit, sipas degëve të industrisë, ujërat e përdorura, kur janë brenda normave të lejuara të purifikimit, shkarkohen vetëm në ujëra sipërfaqësore rrjedhëse.

4. Shkarkimet e lejuara për çdo njësi prodhuese ose objekt (projekt) industrial, parashikohen që në fazën projektuese dhe pasqyrohen në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), të paraqitur nga propozuesi.

Neni 9

Shkarkimet e lëngëta në zonat industriale

1. Në zonat industriale, për trajtimin e shkarkimeve të lëngëta, ndërtohen disa impiante, në përputhje me kapacitetet dhe veçoritë e degëve të ndryshme të industrisë që veprojnë në atë zonë (impiante të precipitimit kimik, për të trajtuar mbetjet e metaleve toksike, impiante të trajtimit biologjik, për të trajtuar mbetjet organike).

2. Llumrat dhe pezullitë të trajtohen për t'u minimizuar dhe, nëse ka prani të metaleve toksike, ato të zhduken me metoda të përshtatshme.

Neni 10

Shkarkimet e lëngëta të një procesi të çfarëdollojshëm

Shkarkimet e lëngëta, si rezultat i filtrimeve të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta, nga veprimtaritë bujqësore ose nga një proces tjetër i çfarëdollojshëm, nuk duhet të kalojnë nivelet e normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta të një procesi çfarëdo.

Neni 11

Trajtimi mjedisor i ujërave të ndotura urbane

1.Shkarkimet urbane i nënshtrohen trajtimit mjedisor paraprak, i cili përfshin:

a) ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për lëvizjen e ujërave të ndotura nga banesat drejt rrjetit të kanalizimeve urbane;

b) ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve të shkarkimeve të lëngëta, në zonat urbane dhe rurale, duke respektuar kriteret e mbrojtjes së mjedisit. Këshilli i Ministrave miraton kriteret mjedisore të ndërtimit dhe të funksionimit të sistemit të kanalizimeve, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Ministrit të Shëndetësisë;

c) në rastet kur rrjeti i kanalizimit nuk mund të ndërtohet, vendosen sisteme të tjera, që garantojnë mbrojtjen e mjedisit;

ç) trajtimin e tyre të ndarë nga shkarkimet e tjera të lëngëta;

d) ndërtimin dhe funksionimin e impianteve të trajtimit të tyre para shkarkimit në ujërat sipërfaqësore;

dh) shkallën e trajtimit të tyre, e cila duhet të jetë në lidhje të ngushtë me veçoritë e mjedisit pritës, ku ujërat e trajtuara urbane shkarkohen përfundimisht.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij neni janë të detyrueshme si për zonat urbane intensive dhe për ato jointensive.

3. Zonat turistike ekzituese dhe ato me zhvillim të pritshëm të turizmit pajisen me sistem kolektor (kanalizimesh) të shkarkimeve të lëngëta urbane.

4. Për shkarkimet e lëngëta urbane zbatohen normat kufi të lejuara.

Neni 12
Trajtimi i ujërave të ndotura urbane

Shkarkimet e lëngëta urbane i nënshtrohen një trajtimi të rreptë, veç trajtimit parësor e dytësor dhe, në raste të veçanta, edhe trajtimit purifikues përkatës.

Neni 13
Trajtimi i ujërave të ndotura urbane në zonat më pak të ndjeshme

1. Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat më pak të ndjeshme u nënshtrohen procedurave të trajtimit parësor, me kusht që të mos ketë rritje të ndikimeve negative në mjedisin pritës.
2. Nëse Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit vëren se ka dhe vazhdon të ketë ndikime negative në mjedisin pritës, urdhëron trajtimin dytësor të shkarkimeve të lëngëta urbane.

Neni 14
Identifikimi dhe miratimi i zonave

1. Identifikimi i zonave të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme bëhet jo më rrallë se një herë në 4 vjet.
2. Miratimi i zonave të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 15
Shkarkimet në zonat malore

Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat malore, për arsye të temperaturave të ulëta, ku është i vështirë të zbatohet impianti i trajtimit biologjik, i nënshtrohen trajtimit fiziko-kimik, me kusht që të mos rriten ndikimet negative në mjedis.

Neni 16
Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta

1. Në normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta përfshihen:
a) normat e lejuara të shkarkimeve industriale;
b) normat e lejuara të shkarkimeve të zonave industriale;
c) normat e lejuara të shkarkimeve të një procesi çfarëdo;
ç) normat e lejuara të shkarkimeve urbane.
2. Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të ministrave përkatës.

Neni 17
Rehabilitimi i mjedisit pritës

Kur Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit vëren tejkalime të normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta në mjedisin pritës, urdhëron ndërprerjen e shkarkimeve të mëtejshme, deri në rehabilitimin e mjedisit të ndotur dhe respektimin e normave.

KREU IV
LEJA MJEDISORE

Neni 18
Kushtet e lejes mjedisore
(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011)

Neni 19
Përjashtimi nga tarifa

Personat fizikë dhe juridikë, që realizojnë trajtimin e ujërave të ndotura, përjashtohen nga tarifa e shërbimit për pajisjen me leje mjedisore.

KREU V
MONITORIMI

Neni 20

1. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura, si dhe ata që kanë marrë përsipër trajtimin e shkarkimeve të lëngëta urbane, shtëpiake, industriale dhe të çfarëdo procesi, organizojnë dhe realizojnë, me shpenzimet e veta, monitorimin e këtyre veprimtarive.

2. Për realizimin e monitorimit, personat fizikë dhe juridikë specializojnë punonjës të tyre ose kontraktojnë me institute të specializuara, të angazhuara në realizimin e Programit Kombëtar të Monitorimit.

3. Monitorimit i nënshtrohen të gjitha fazat e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta, përfshirë dhe mjediset pritëse.

4. Monitorimi i veprimtarisë vetjake realizohet në përputhje me kërkesat e Programit Kombëtar të Monitorimit, si dhe në bazë të programit individual të monitorimit, të cilin personi fizik ose juridik e paraqet bashkë me kërkesën për t'u pajisur me leje mjedisore.

5. Programi individual përfshin:

a) përcaktimin e metodave bashkëkohore në përputhje me veçoritë e shkarkimeve të lëngëta;

b) përcaktimin e frekuencës së matjeve dhe të pikave të marrjes së mostrave, në përputhje me madhësinë e impiantit të trajtimit dhe veçoritë e mjedisit pritës.

KREU VI
KONTROLLI

Neni 21

1. Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, organi që ka lincencuar veprimtarinë, Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit dhe inspektorati bashkiak ushtrojnë kontrolle për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta.

2. Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit kontrollon zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe kushtet e vendosura në lejen mjedisore.

KREU VII
SANKSIONET

Neni 22
Veprime të ndaluara

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohen:

a) shkarkimi në tokë ose në ujëra sipërfaqësore i ujërave të ndotura përtej limiteve, që përcaktojnë normat e lejuara për shkarkimet e lëngëta;

b) trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura jashtë vendeve të përcaktuara për këtë qëllim;

c) trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura nga personat fizikë e juridikë, të palicencuar për këto veprimtari;

ç) trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura me teknika dhe teknologji të papërshtatshme dhe të pamiratuara me një akt normativ;

d) përzierja me ujëra sipërfaqësore i shkarkimeve të lëngëta të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta, si dhe të dampave;

dh) përdorimi i ujërave të ndotura për çdo qëllim ose veprimtari.

Neni 23
Kundërvajtjet administrative

1. Kur shkeljet e kërkesave të këtij ligji përbëjnë vepër penale, sipas kreut "Vepra penale kundër mjedisit" të Kodit Penal, Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit bën kallëzim për ndjekje penale.

2. Shkeljet e kërkesave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative, për rastet si më poshtë:

a) ushtrimi, pa leje mjedisore, i veprimtarive me shkarkime të lëngëta në mjedis, si dhe i veprimtarive për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;

b) mosrespektimi i kushteve dhe kërkesave të vendosura në lejet mjedisore për administrimin mjedisor të ujërave të ndotura e të përdorura;

c) moskryerja e trajtimit parësor të shkarkimeve të lëngëta nga veprimtaritë që shkarkojnë ujëra të ndotura;

ç) shkarkimet e pakontrolluara të ujërave të ndotura, kur nuk ka sisteme kanalizimesh brenda territorit të veprimtarisë, kur nuk ka sisteme të tilla nga veprimtaria deri në kolektor ose kur këto sisteme nuk funksionojnë;

d) mosinstalimi dhe mosvënia në punë e impianteve të trajtimit të shkarkimeve të lëngëta, brenda veprimtarisë që shkarkon ujëra të ndotura, si dhe në veprimtaritë që kanë marrë përsipër trajtimin dhe pastrimin e këtyre ujërave;

dh) shkelja e kërkesave dhe e rregullave për funksionimin e impianteve dhe të instalimeve për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;

e) mosmbajtja e regjistrit të shkarkimeve të lëngëta;

ë) moskryerja e procesit të monitorimit;

f) mosdhënia e informacionit dhe mospublikimi i të dhënave të monitorimit;

g) mosvënia në dijeni e popullatës për ndotjen e ujërave, për rreziqet e mundshme në shëndet dhe për masat mbrojtëse që duhen marrë në rastet e shkarkimeve tej normave të lejuara.

Neni 24
Dënimet dhe masat urgjente
(Ndryshuar me ligjin nr. 34/2013, datë 14.2.2013)

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit jep dënim kryesor me gjobë si më poshtë:

a) Për shkronjat “e”, “ë”, “f” dhe “g” nga 100 000 deri në 300 000 lekë;

b) Për shkronjat “a”, “b”, “e” dhe “dh” nga 300 000 deri në 500 000 lekë;

c) Për shkronjat “ç” dhe “d” nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit mund të vendosë edhe dënimin plotësues të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit të shkaktuar.

3. Shqyrtimi dhe marrja përfundimtare e vendimit bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Sipas nevojave të rastit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin, inspektorati merr masa urgjente.

Neni 25

Ankimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 34/2013, datë 14.2.2013)

Kundër vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 26

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11 pika 1 shkronja "b", 14 pika 2 dhe 16 pika 2 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas miratimit të tyre nga Kuvendi.

2. Ngarkohet Ministri i Mjedisit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas miratimit të tyre nga Kuvendi.

Dispozitë kalimtare

(e ligjit nr. 34/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3941, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu